



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
SP-082
Prishtinë, më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 NËNTOR DHE 1 DHJETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i hapi punimet e Kuvendit, sipas rendin e ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të procedohen pikat e rendit të ditës, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Zenun Pajaziti, propozoi që pika e 13-të e rendit të ditës: Projektligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, të shqyrtohet si pikë e parë e rendit të ditës.

Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Projektligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij të shqyrtohet pikë e parë e rendit të ditës.

Pastaj, Kuvendi i zhvilloi punimet me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Kryetarja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, znj. Duda Balje, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në projektligj ishin propozuar 13 amendamente nga Komisioni Funksional. Kryetari i hodhi në votim të gjitha amendamentet përnjëherë. Kuvendi i miratoi amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional nga 1-13.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për 72,
Kundër 0,
Abstenime 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Projektligji nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

* * *

Pas kësaj pike, kryetari i GP të LVV-së, Glauk Konjufca, propozoi të mbahet seancë e jashtëzakonshme për të diskutuar lidhur me rastin e vdekjes së Astrit Deharit. Diskutimi i deputetit është dhënë në transkript.

Kryetari tha se kërkesa e GP të LVV-së për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme duhet të procedohet në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit. Po ashtu, peticioni i qytetarëve për zbardhjen e vdekjes së Astrit Deharit i është dërguar Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione. Diskutimi i kryetarit është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryetari kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen lidhur me propozimin e z. Konjufca.

Lidhur me propozimin e z. Konjufca diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri në emër të GP të LVV-së, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së, Valdete Bajrami, në emër të GP “NISMA” dhe Müfera Şinik, në emër të GP “6+”. Diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e deputetit Glauk Konjufca për seancë të jashtëzakonshme.

Rezultatet e votimit ishin, si në vijim:

Për 26,
Kundër 0,
Abstenim 0,

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi kërkesën për seancë të jashtëzakonshme.

Pastaj, kryetari i procedoi pikat e tjera të rendit të ditës:

2. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekim Haxhiu, Pal Lekaj, Zafir Berisha, Fikrim Damka, Emilija Rexhepi, Ismajl Kurteshi, Xhevahire Izmaqu dhe Sali Salihu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Bislim Zogaj i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me rifillimin e punës së Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Shukrije Bytyçi i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me konkursin për specializantë.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra i tërhoqi dy pyetjet parlamentare të proceduara për këtë seancë, me nr. DO-1335 dhe DO-1336, të datës 17 tetor 2016.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me procedurat e homologimit të veturave.

Ministri Lutfi Zharku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Rustem Berisha i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me fillimin e punës së Sekretarisë të Komisionit Qeveritar për Verifikimin e Statusit të Veteranëve, Invalidëve dhe Dëshmorëve.

Kryeministri nuk arriti t'i japë përgjigje kësaj pyetjeje për shkak të pengimit në foltoren e Kuvendit nga disa deputetë të GP të LVV-së, të cilët ishin duke e mbajtur pankartën me mbishkrimin "Drejtësi për Astrit Deharin".

4. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 27, 28 tetor dhe 17 nëntor 2016.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Kryesuesi i seancës, Xhavit Haliti, i njoftoi deputetët se Komisioni për Integritet Evropian dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj, në mënyrë që të hyjë në fuqi para 31 dhjetorit 2016, për shkak të afateve kontraktuale që ka Kosova me Bashkimin Evropian.

Në emër të Komisionit Funkcional, znj. Njomza Emini e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për projektligjin diskutuan deputetët: Fatmir Xhelili, Naser Osmani dhe Qerim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, votimi i projektligjit u shty për të nesërmen, në seancën e orës 10:00.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka propozuar që shqyrtimi dhe miratimi i këtij projektligji të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj sipas procedurës së rregullt të paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale diskutuan: Selville Halimi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së, si dhe deputetët Arben Gashi, Nait Hasani dhe Fatmir Xhelili, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore diskutuan: Selvije Halimi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së dhe Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, edhe kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike diskutuan: Naim Fetahu, në emër të Komisionit Funkcional dhe në emër të GP të PDK-së, si dhe Salih Morina, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, edhe kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, në emër të Qeverisë së Kosovës e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor diskutuan: Flora Brovina, në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Fadil Beka, në emër të GP të PDK-së, Mirjeta Kalludra, në emër të GP të LDK-së, Fikrim Damka në emër të GP “6+”, si dhe deputetët: Salihe Mustafa dhe Nehat Baftiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, edhe kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Shala, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë diskutuan: Salihe Mustafa, në emër të Komisionit Funkcional dhe në emër të GP të PDK-së, Salih Morina, në emër të GP të LDK-së, Gëzim Kelmendi, Sabri Hamiti, Hajdar Beqaj, Ali Sadriu dhe Nait Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi tha se për votimin e këtij projektligji kërkohen të paktën 61 vota për, prej tyre 11 vota “për” të komuniteteve që nuk janë shumicë. Votimi i këtij projektligji do të bëhet kur konsiderohet se do të sigurohet ky kuorum.

Kryesuesi, pas shqyrtimit të kësaj pike, në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare dha pauzë deri në orën 15:20.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se ky projektligj ka qenë i radhitur në seancën plenare të 10 marsit 2016 dhe është tërhequr nga Qeveria e Kosovës. Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Projektligjin për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë diskutuan: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit FunkSIONAL, Besim Beqaj në emër të GP të PDK-së, Blerim Grainca, në emër të GP të LDK-së, si dhe deputetët: Raif Qela, Fatmir Rexhepi dhe Fatmir Xhelili, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërme, në orën 10:00.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa

Pasi që për votimin e amendamenteve të projektligjeve në pikën **12 dhe 13** nuk kishte kuorum, atëherë ato u shtynë për seancën e së nesërme.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi e ftoi Auditorin e Përgjithshëm që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015.

Auditori i Përgjithshëm, z. Besnik Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015. Diskutimi i tij është dhënë i plotë në transkript.

Lidhur me raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015 diskutuan: Abdyl Ymeri në emër të Komisionit FunkSIONal për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së, Muhamet Mustafa, në emër të GP të LDK-së, Selvije Halimi, Avdullah Hoti, ministri i Financave dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

15. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi e ftoi z. Naser Osmani, kryetar i Komisionit FunkSIONal për Buxhet dhe Financa, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015, si dhe rekomandimin e komisionit për miratimin e këtij raporti.

Lidhur me raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 diskutuan: Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

Pastaj, kryesuesi e procedoi pikën e 20-të të rendit të ditës.

20. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni ad hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e dy anëtarëve me votim të fshehtë, nga katër kandidatët e propozuar si në vijim: Afërdita Maliqi; Naile Demiri; Ganimet Klaiqi dhe Hazbije Qeriqi.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit ad hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Kryetari i Komisionit ad hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit, z. Salih Morina, e paraqit dhe e arsyetoi raportin e komisionit me rekomandim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim të fshehtë për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

16. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL ka shqyrtuar raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Deputeti Adem Salihaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit me rekomandim për miratim.

Lidhur me raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë diskutoi edhe deputetja Emilija Rexhepi. Diskutimi i saj është dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

17. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017 dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL që ta paraqesë dhe ta arsyetojë rekomandimin lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017.

Naser Osmani, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin e komisionit për miratimin e kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale për caktimin e taksave vjetore për vitin 2017.

Lidhur me rekomandimin e komisionit diskutoi edhe deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së. Diskutimi i saj është dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe kryesuesit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOST sh. a.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe kryesuesit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOST sh.a. dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL që ta paraqesë dhe ta arsyetojë Propozim-vendimin e komisionit.

Naser Osmani, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-vendimin për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe kryesuesit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOST sh.a. Ai kërkoi që në pikën e 6-të të Propozim-vendimit të bëhet një ndryshim teknik. Pra, në vend të fjalës “bëhet”, në vendim të shkruhet fjala “paguhen”.

Lidhur me Propozim-vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa diskutuan: Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së, Armend Zemaj, Xhevahire Izmaçu dhe Nehat Baftiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërme, në orën 10:00.

19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Naser Osmani, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-vendimin e komisionit për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit për Trashëgimi Kulturore. Ai kërkoi të bëhet një ndryshim teknik në pikën 4 të Propozim-vendimit: fjala “pagë” të zëvendësohet me fjalën “kompensim”.

Lidhur me Propozim-vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa diskutuan: Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së dhe Nehat Baftiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në mungesë të kuorumit, edhe kjo pikë u shty për votim për seancën e së nesërmes, në orën 10:00.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:15 minuta, për të vazhduar të nesërmen, më 1 dhjetor 2016, në orën 10:00.

* * *

E enjte, më 1 dhjetor 2016

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 30 nëntor 2016

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë dhe i procedoi pikat e papërfunduara nga seanca e djeshme, si në vijim:

5. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale

Kryesuesi disa herë e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, mirëpo asnjëherë nuk e mori numrin e mjaftueshëm të votave për miratim. Votimi i këtij projektligji u shty për votim në ndonjë seancë tjetër.

6. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të procedurës përmbartimore

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të procedurës përmbartimore.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër----- 0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Votimi i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër----- 0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për kontrollin e brendshëm të financave publike.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Votimi i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër----- 0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për Inspektoratin Shëndetësor.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Votimi i Projektligjit për tregtinë dhe produktet e naftës dhe karburantet e ripërtëritshme në Kosovë

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për tregtinë dhe produktet e naftës dhe karburantet e ripërtëritshme në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 53,
Kundër----- 4,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për tregtinë dhe produktet e naftës dhe karburantet e ripërtëritshme në Kosovë.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	62,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji për performansën energjetike në ndërtesa.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	64,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Projektligji për akreditim.

14. Votimi i rekomandimeve të Komisionit FunkSIONAL lidhur me raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi këto:

R E K O M A N D I M E

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të përgatisë raport kthyes në lidhje me rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm, Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Seanca Plenare për raportin vjetor të auditimit për vitin 2015, duke detajuar progresin e arritur dhe duke identifikuar barrierat që e kanë penguar implementimin e plotë të rekomandimeve.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të përgatisë një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm nga raporti vjetor i auditimit 2015, si dhe të raportojë për progresin e arritur në zbatim të këtij plani, në baza tremujore, në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga të gjitha organizatat buxhetore që të implementojnë dhe të raportojnë mbi procesin sistematik të implementimit të rekomandimeve të auditorit të jashtëm, me raporte tremujore të progresit të dërguara në Ministrinë e Financave dhe në KMFP.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës të ushtrojë ndikim te Qeveria për të siguruar që rekomandimet e KMFP-së dhe AP-së për vitin aktual dhe ato paraprake po adresohen plotësisht, duke vendosur kontrole efektive gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe duke siguruar vlerën për para.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës të kërkojë nga Qeveria të ketë një strategji, e cila demonstroi një qasje të koordinuar për maksimizimin e performansës së komunave.

16. Votimi i raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015

Kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

17. Votimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017

Kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet taksa operacionale prej 0,081 % dhe taksa investive prej 0,393 % për vitin 2017 e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

18. Votimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet e Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarit të Bordit të Drejtorëve dhe të kryesuesit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh. a.

Kryesuesi e hodhi në votim Propozim-vendimin e Komisionit FunkSIONAL.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a. i caktohet paga në shumën prej 1,550€ bruto në muaj.
2. Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a. i caktohet paga në shumën prej 1,350€ bruto në muaj.
3. Kryesuesit të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a. i caktohet paga në shumën prej 120€ bruto për pjesëmarrje në një mbledhje.
4. Anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a. i caktohet paga në shumën prej 100€ bruto për pjesëmarrje në një mbledhje.
5. Pagat për kryesuesin dhe anëtarët e Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a., sipas pikave 3 dhe 4 të këtij Propozim-vendimi, paguhen më së shumti për pjesëmarrje në 6 (gjashtë) mbledhje brenda një viti.
6. Niveli i pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, i kryesuesit dhe i anëtarëve të Komisionit të Auditimit, sipas pikës 1 deri në 5 të këtij vendimi paguhen nga buxheti i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut– KOSTT sh.a., dhe zbatohet deri në miratimin e ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

19. Votimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit për Trashëgimi Kulturorë

Kryesuesi e hodhi në votim Propozim-vendimin e Komisionit FunkSIONAL.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 54,

Kundër ----- 2,

Abstenime ----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Kryetarit të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë i caktohet kompensimi në shumën prej 800€ bruto në muaj.
2. Nënkyetarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë i caktohet kompensimi në shumën prej 700€ bruto në muaj.

3. Anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore u caktohet kompensimi në shumën prej 600€ bruto në muaj.
4. Niveli i kompensimit për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, sipas pikës 1 deri në 3 të këtij vendimi, zbatohet deri në miratimin e ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publikë.
5. Shfuqizohet Vendimi nr. 03-V-222, datë 27 tetor 2009, i Kryesisë së Kuvendit për caktimin e pagave për Këshillin e Kosovës për Trashëgiminë Kulturore.

4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Kryesuesi i njoftoi deputetët me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pra, ratifikimi i marrëveshjes kërkon së paku 80 vota “për”.

Lidhur me këtë projektligj diskutuan deputetët: Ismet Beqiri, Pal Lekaj, Valdete Bajrami, Melihate Tërmkolli, Daut Haradinaj dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	81,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

20. Zgjedhja e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare të propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues dhe meqenëse mungonin 4 grupe parlamentare, të propozohet dikush nga radha e deputetëve pa grup parlamentar.

Me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, Kuvendi e formoi Komisionin votues në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, PDK,
2. Salih Morina, LDK,
3. Qerim Bajrami, “6+” dhe
4. Margarita Kadriu-Ukelli, pa grup parlamentar.

Pastaj, kryesuesi i ftoi deputetët që të votonin për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga katër kandidatët e propozuar nga ana e Komisionit ad hoc.

Gjatë procedimit të votimit është vërejtur nga Komisioni votues se është bërë një lëshim teknik në fletëvotim. Në vend të emrit të kandidates Hazbije Qeriqi ishte shënuar gabimisht emri Naim Krasniqi (i cili kishte qenë kandidat për Këshillin Prokurorial të Kosovës).

Pas korrigjimit të fletëvotimit, kryesuesi riprocedoi votimin nga fillimi, duke i ftuar deputetët një nga një që të votojnë për kandidatët e propozuar.

Pas përfundimit të procedurave të votimit dhe numërimit të votave, deputetja Xhevahire Izmaku, në emër të Komisionit votues, e paraqiti rezultatin e votimit, si në vijim:

Në votim kishin marrë pjesë 62 deputetë.
Të pavlefshme ishin 4 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

Afërdita Maliqi, 50 vota,
Naile Demiri, 44 vota,
Ganimet Klaiqi, 4 vota dhe
Hazbije Qeriqi, 3 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjodhi znj. Afërdita Maliqi dhe znj. Naile Demiri anëtare të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar me mandat 3 (tre) vjeçar.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës në orën 11:55.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*